

**PROGRAMA PËR PERKRAHJE FINANSIARE NË BUJQËSI PËR VITIN
2018**

UDHËZUES PËR SHFRYTZUESIT

PËRMBAJTJA

I. KUSHTET E PËRGJTHSHME	3
II.PROCEDURA PËR DORËZIMIN E KËRKESËS PËR PAGESAT DIREKTE	4
1. Shqyrtimi para dorëzimit të kërkesës.....	4
2. Dorëzimi i Kërkesës për pagesat direkte	4
3. Tërheqja, ndryshimi dhe plotësimi i kërkesës së dorëzuar	5
4. Gabimet më të shpeshta të cilat i bëjnë kërkuarit.....	5
5. Datat e rëndësishme për vitin 2018	7
III.LARTËSIA E PËRKRAHJES	8
Masat për përkrahjen e të ardhurave nga ekonomitë bujqësore.....	8
Masa për mbështetje plotësuese të zhvillimit të bujqësisë (mbështetja shtetërore në bujqësi)...	16
MASAT PËR ZHVILLIM RURAL.....	17
IV. KONTROLLI NË TEREN	21
1. Çka është kontrolli në teren?	21
2. Kush e kryen kontrollin në vend?.....	21
3. Si kontrollohen kulturat për nga sipërfaqja?	21
4. Si kontrollohen kafshët?	21
5. Si kryhet kontrolli për Praksë të Mirë Bujqësore (PMB)?	22
6. Si duhet të veproni gjatë zbatimit të kontrollit?	22
V. Llogaritja e pagesave direkte sipas sipërfaqes së tokës bujqësore	22
VI.Llogaritja e pagesave direkte për kokë kafshe	23
VII.Pagesa e mjeteve	23
XI. SHTOJCA.....	24
SHTOJCA 1	24

A. HYRJE

I. Kushtet e përgjithshme

Të drejtë shfrytëzimi të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2018 kanë ekonomitë bujqësore të regjistruara në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (në tekstin e mëtutjeshëm: RVEB) i cili udhëhiqet në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave (në tekstin e mëtutjeshëm Ministria).

Realizimi i masave për pagesat e drejtpërdrejta për sipërfaqe bëhet në bazë të kërkesave që duhet të përmbajnë të dhëna për sipërfaqen e parcelave kadastrale të evidentuara në RVEB më së voni deri më 15 mars të vitit 2018. Sipërfaqja e lejuar maksimale e parcelave kadastrale për të cilat parashtrohet kërkesa në mënyrë të plotësuar është kufizuar me sipërfaqen të evidentuar në sistemin për identifikim të parcelave të tokës (SIPT) me përdorim të përcaktuar të tokës bujqësore të ekonomisë bujqësore me gjendje më 15 mars 2018. Gjatë kontrollimit të vendit përcaktimi i madhësisë së sipërfaqes të kulturës së deklaruar i bëhet parcelës së tërësishme të evidentuar në SIPT dhe për të gjitha SIPT parcelat, të cilat si bazament tërësisht ose pjesërisht i kanë parcelat kadastrale të evidentuara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe të cilat janë të theksuara në kërkesë.

Realizimi i masave të pagesave të drejtpërdrejta në aspektin e përcaktimit të gjendjes numerike të gjedheve, deleve, dhive dhe familjeve të bletëve bëhet në bazë të të dhënave nga Regjistri për identifikim dhe regjistrim të kafshëve shtëpiake në ditën e parashtrimit të kërkesës.

Përcaktimi i gjendjes numerike të dosave bëhet në bazë të vërtetimeve të dhëna nga shoqëritë e regjistruara të veterinarëve.

Realizimi i pagesave plotësuese të drejtpërdrejta për kafshët shtëpiake nga rasat autoktone në aspekt të përcaktimit të gjendjes numerike të gjedhëve, deleve, dhe dhive bëhen në bazë të të dhënave nga Libri i amzës së Organizatës së pranuar të ruajtësve, të përcaktuar nga Organizata e pranuar e ruajtësve, ndërsa të vërtetuar nga kryesit e shërbimit publik për realizimin e masave dhe aktiviteteve nga Programi i Përbashkët Bazë për Ruajtjen e Gjedhëve (PPBRGJ).

Shfrytëzuesi i mjeteve duhet të ketë të plotësuar edhe kushtet në vijim:

- Kërkesën ta parashtrojë në afat të caktuar;
- Të mundësojë kryerjen e kontrollit nga ana e kontrollorëve të Agjencisë të të gjitha sipërfaqeve bujqësore dhe të gjitha kafshëve shtëpiake,
- Të dorëzojë plotësim të dokumentacionit të kërkuar në afatin i cili është caktuar nga ana e Agjencisë,
- Të përmbushë kërkesat e caktuara në Listën e kushteve të posaçme minimale për praktikë të mirë bujqësore dhe mbrojtje të mjedisit jetësor,
- Të respektojë obligimet të cilat dalin nga Urdhri për mbrojtje shëndetësore të kafshëve dhe Ligji për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve.

Shfrytëzuesi i mjeteve duhet ti ketë të shlyera të gjitha obligimet financiare si në vijim kundrejt:

- Obligimet ndaj Agjencisë;
- Obligimet që dalin nga qiraja për shfrytëzim të tokës bujqësore të shtetit;
- Obligimet që dalin nga qiraja për shfrytëzimin e kullosave shtetërore;
- Obligimet që dalin nga kompensimi i ujit;
- Obligimet që dalin nga Koncesioni i peshqve për peshkim ekonomik dhe rekreativ;
- Obligimet që dalin nga koncesioni për dhënie të kafshës së egër në vendet e shfrytëzuara për gjueti;
- Obligimet që dalin nga marrëveshjet e lidhura për shfrytëzim të mjeteve nga fondet e kompensimit nga ndihma e jashtme për të cilat e autorizuar është ministria dhe
- Obligime që dalin në bayë të taksave për të cilat perjegjës është Drejtoria për të hzra publike.

Shfrytëzimi dhe pagesa e mjeteve bëhet pasi të realizohet procedura e pagesës së obligimeve të papaguara dhe të porealizuara financiare të shfrytëzuesit të mjeteve nga shuma e mbështetjes së lejuar financiare.

II. Procedura për dorëzimin e kërkesës për pagesat direkte

1. Shqyrtimi para dorëzimit të kërkesës

Para dorëzimit të kërkesës bartësi i ekonomisë bujqësore duhet t'i kryejë kontrollet në vijim gjegjësisht azhurnimet në regjistrat përkatës:

- Kontroll të të dhënave personale të evidentuara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore i cili udhëhiqet në njësitë rajonale të Ministrisë
- Kontroll të të dhënave të evidentuara në Regjistrin për identifikim dhe regjistrim të kafshëve shtëpiake në shoqatën e veterinarisë me të cilën blegtori ka lidh marrëveshje.

ME RËNDËSI!!!

Dorëzimi i kërkesave për masat për sipërfaqe kryhet në bazë të të dhënave në NJZHEB dhe RVEB me gjendjen në 15 mars të vitit 2018. Për parcelat e regjistruara pas këtij afati nuk do të paguhen pagesa direkte për vitin 2018.

Dorëzimi i kërkesave për gjedhe, dele dhe dhi bëhet në bazë të të dhënave në Regjistrin për identifikim dhe regjistrim të kafshëve shtëpiake në ditën e dorëzimit të kërkesës.

2. Dorëzimi i Kërkesës për pagesat direkte

Kërkesa e vetme dorëzohet në mënyrë elektronike (e-kërkesa) nga ana e ekonomisë bujqësore. Që të dorëzohet kërkesë elektronike (e-kërkesë) duhet të kryhen procedurat e mëposhtme:

1. **Regjistrimi i kërkuarit në sistem** nëpërmjet të ueb faqes së Agjencisë www.ipardpa.gov.mk duke zgjedhur pjesën "Pagesa direkte për e-kërkesa". Regjistrimi bëhet duke hyrë me NRID për ekonomi bujqësore nga REVb, futjen e të dhënave NAPQ / NVT i ekonomisë bujqësore, adresën e-mail dhe fjalëkalimin të cilën kërkuarit e formojnë sipas zgjedhjes së tyre gjatë regjistrimit.
2. **Qasja në sistemin** - pas regjistrimit të suksesshëm të e-mailit adresës së të paraqitur të ekonomisë bujqësore do tu dërgohet një link me të cilën ekonomia bujqësore mund të qaset në sistemin me qëllim të krijimit dhe dorëzimit të kërkesës për pagesa të drejtpërdrejta.

ME RËNDËSI !!!

Pas qasjes së suksesshme në sistem, kërkuarit do ti jetë i disponueshëm udhëzimi elektronik me procedura të përshkruara në detaje për krijimin dhe dorëzimin e kërkesës

3. **Krijimi dhe dorëzimi i kërkesës elektronike (e-kërkesa)** – gjatë dorëzimit të kërkesës elektronike (e-kërkesa) përdoren të dhënat për parcelat bujqësore dhe kafshët (gjedhe, dele dhe dhi), që janë të maruna automatikisht nga regjistrat përkatës. Kërkuari e regjistron kulturën bujqësore për secilën parcelë veç e veç, duke krijuar një plan të prodhimit. Hapi tjetër është zgjedhja e masave dhe nën-masat për të cilat kërkohet përkrahja financiare. Për masat për sipërfaqe kërkesa plotësohet me të dhëna për parcelat kadastrale të regjistruar në RVEB me madhësinë maksimale të lejuar e cila është e regjistruar në SIZP dhe sipas të një të drejte të definuar të pronësisë/përdorimit dhe sipas llojit të përdorimit të tokës bujqësore.

Për masat për gjedhe, dhen e dhi kërkesa plotësohet me të dhëna të numrit të markave(pullave) të veshit të shënuara në Regjistrin për identifikim dhe regjistrim të kafshëve shtëpiake.

Numri i llogarisë së transaksionit të regjistrohen nga kërkuarit (e njëjta nuk tërhiqet me automatizëm) ku sistemi automatikisht kontrollon nëse numri i llogarisë së transaksionit korrespondon me numrin amë/tatimor të kërkuarit. Nëse të dhënat nuk përputhen, sistemi do të lëshojë një paralajmërim dhe një mundësi për të regjistruar një numër tjetër të llogarisë së transaksionit.

Pasi kërkesa elektronik (e-kërkesa) do të dorëzohet, e njëjta nga ana e kërkuarit duhet të nënshkruhet dhe të shtypet dhe të dorëzohet në Agjencinë në adresën në vijim:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Rr. "Treta makedonska brigada" nr. 20

1000, Shkup.

ME RËNDËSI!!!

Për parashtrim të rregullt të kërkesës konsiderohet kërkesa e cila është përpiluar në mënyrë elektronike, e printuar, nënshkruar nga ana e parashtruesit dhe e dorëzuar deri në Agjenci.

Për kërkesat e paparashtruara deri tek Agjencia nuk do të mbahet llogari.

Për masat për të cilat është përcaktuar nevoja e dorëzimit të dëshmime plotësuese, të njëjtat dorëzohen si shtojcë e kërkesës.

ME RËNDËSI !!!

Para nënshkrimit të kërkesës është e domosdoshme të lexohen të dhënat e futura. Tu kushtohet kujdes të gjitha të dhënave për parcelat bujqësore, numrin e markave (pullave) të veshit për të gjitha kokat e kafshëve dhe masën /nën masën e zgjedhur.

Procesi i përpunimit realizohet vetëm për parcelat e evidentuara, numrat e markave (pullave) të veshit dhe masat/nën masat në kërkesë.

Për gabimet eventuale të të dhënave të futura përgjegjës është kërkuari.

Kërkuari është i obliguar ta ruajë tërë dokumentacionin për mbështetjen e shfrytëzuar financiare së paku pesë vjet.

4. Për ndihmë gjatë dorëzimit të kërkesës elektronike (e-kërkesë) - ekonomia bujqësore mund të drejtohet në njësinë rajonale të ministrisë.

Paraqitja e kërkesave për qumësht të prodhuar dhe shitur, kërkesa për ndihmë në primet e sigurimit, kërkesa për shitjen e pemëve dhe perimeve në kapacitetet përpunuese, kërkesa për prodhimin organik bëhet në mënyrë elektronike në njësinë rajonale të ministrisë ku është regjistruar ekonomia bujqësore.

Për nën-masës 1.2 Pagesat shtesë të drejtpërdrejta nga nën-masa 1.1. për sipërfaqen e tokës së punueshme bujqësore me madhësi nga 10 deri në 50 hektarë dhe nënmasën 1.19 Pagesa të drejtpërdrejta plotësuese nga nënmasat 1.5, 1.9, 1.12 për përkrahje për ndryshim të llojit të prodhimit të kulturave të drithërave në kultura kopshtore, mbjellje pemishte dhe vreshtave, bëhet në mënyrë të shkruar në bazë të formulareve të përcaktuara, për nënmasën 2.15 Pagesa direkte për vezë bartëse të futura në kapacitet për prodhimin e vezëve dhe nënmasa 9 pagesa direkte për ruajtjen e grurit nga prodhimi vendor nga rekolti i vitit 2018 kërkesat dorëzohen në formë të shkruar në Agjencion.

3. Tërheqja, ndryshimi dhe plotësimi i kërkesës së dorëzuar

Kërkesa për pagesa direkte në përgjithësi apo pjesë pjesë mund të tërhiqet, ndryshohet apo të plotësohet me shkrim nga ana e dorëzuesit më së voni në afat prej 30 ditë nga dorëzimi, përpos nëse bartësi i ekonomisë bujqësore është veç më i informuar për qëllimin e kryerjes së kontrollit në vend, apo për ekzistimin e parregullsive në kërkesën.

Dërgesa me shkrim për tërheqje, ndryshim dhe/apo plotësim të kërkesës dorëzohet deri te Agjencia, ndërsa ndryshimet evidentohen në mënyrë elektronike në njësinë rajonale ku është dorëzuar kërkesa.

ME RËNDËSI!!!

Krijimi dhe parashtrimi i plotësimit të kërkesës bëhet në të njëjtën mënyrë si krijimi dhe parashtrimi i kërkesës së parë

Dorëzimi me shkrim për tërheqje, ndryshim dhe/ose plotësim të kërkesës dorëzohet në Agjenci.

4. Gabimet më të shpeshta që i bëjnë kërkuarit

Nuk është plotësuar e dhënë për të gjitha masat për të cilat ka mundësi për të parashtruar kërkesë (më së shpeshti dështohet në zgjedhjen e masës për pagesa shtesë).

Deklarimi i numrit të fidanëve që nuk është në pajtim me gjendjen e vetë vendit.

Deklarimi i kulturës bujqësore e cila nuk është në pajtim me gjendjen e vetë vendit.

Deklarim i sipërfaqes me kulturë të caktuar bujqësore nën minimumin e caktuar të nevojshëm.

Mosrespektim i periudhës së ruajtjes së domosdoshme të: gjedhëve, deleve dhe dhive .

Deklarimi i numrit të kafshëve nën minimumin e caktuar të nevojshëm.

Mosdorëzim i lajmërimit deri te Agjencia për secilin ndryshim të bërë në numrin e kafshëve gjatë periudhës së ruajtjes së domosdoshme.

Dorëzim i dokumenteve të plotësuara në mënyrë të parregullt për material të furnizuar të farës (dorëzohen mandat pagesa të paplotësuara, sasia për farë të furnizuar nga misri nuk është shprehur në kilogram por me numër të paketimeve ose numër të thasëve).

Dorëzim të vërtetimeve për kafshë të prera dhe ruajtje të: dosave, strucëve, dhe kërmijve që nuk janë të plotësuara në mënyrë të rregullt dhe nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme që janë caktuar.

Shitja e pemëve dhe perimeve nuk është realizuar tek subjekti i regjistruar për blerje në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural .

Shitja e pemëve dhe perimeve nuk është realizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kapacitet përpunues ose përmes një subjekti të regjistruar për blerje, shpeshherë paraqitet numër më i madh i ndërmjetësuesve.

Sasia e paraqitur e pemëve dhe perimeve nuk korrespondon me sipërfaqen e paraqitur për prodhim.

Dorëzim i të dhënave joqeveritare për numrin e llogarisë së transaksionit.

Dorëzim i kërkesës së nënshkruar në mënyrë të parregullt (kërkesa nuk është nënshkruar nga kërkuesi ose nuk është nënshkruar në të gjitha vendet e parapara për nënshkrim) .

5. Data të rëndësishme për vitin 2018

Afati	Aktivite
Deri 15 mars	Azhurnimi i të dhënave në regjistra (NJZHEB, SIPB dhe Regjistri për kafshë)
Deri 15 maj	Dorëzimi i kërkesave unike (për të gjitha masat themelore dhe plotësuese për sipërfaqe të tokës bujqësore dhe frymë të begatisë)
Deri 16 maj	Dorëzimi i kërkesave për qumësht të prodhuar dhe shitur dhe pagesa të drejtpërdrejta për bartëse të vezëve të futura në kapacitet për prodhimin e vezëve në periudhë prej 1 tetor deri 31 dhjetor të vitit 2018
30 shtator	Periudha e ruajtjes së detyrueshme të kafshëve
Deri 31 gusht	Dorëzimi i kërkesave për ndihmë në premi për sigurime
Deri 15 maj	Dorëzimi i kërkesave për ndihmë për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe ndihmë për kategori të veçanta bartës të ekonomisë bujqësore
Deri 15 qershor	Dorëzimi i kërkesave për qumësht të prodhuar dhe shitur dhe pagesa të drejtpërdrejta për bartëse të vezëve për prodhim të vezëve në periudhë prej 1 janar deri 30 prill të vitit 2018
Deri 15 shtator	Dorëzimi i kërkesave për ruajtjen e grurit nga prodhimi vendor nga rekolti i vitit 2018
Deri 25 dhjetor	Dorëzimi i kërkesave për pemë dhe perime të shitura në kapacitete përpunuese
Deri 25 dhjetor	Dorëzimi i kërkesave për prodhimtari organike (masa për përpunim, tregti, kontroll profesionale dhe certifikim, analiza laboratorike)
Deri 5 nëntor	Dorëzimi i kërkesave për qumësht të prodhuar dhe shitur dhe pagesa të drejtpërdrejta për bartëse të vezëve për prodhim të vezëve në periudhë prej 1 maj deri 30 shtator të vitit 2018

III.Lartësia e përkrahjes

Masat për përkrahjen e të ardhurave nga ekonomitë bujqësore:

Tabela1. Lartësia e përkrahjes për pagesa direkte për prodhimin e bimëve

Numri i nën masës	Titulli i nën masave	Hapësira minimale e përcaktuar	Lartësia e përkrahjes	Dokumentet të cilat kërkuesi i parashton si shtojcë e kërkesës
1.1	Pagesa direkte sipas sipërfaqes së punueshme bujqësore për të gjitha kulturat e fushave përveç duhanit	0,3 ha për të gjitha kulturat ne përgjitsi, 0,15 ha për të gjitha kulturat ne përgjitsi përderisa të gjitha parcelat gjinden në lartësi mbidetare më të madhe se 700m në përputhshmëri me SIPT	- 6.000 den/ha ose 8.400den/ha për EFB me sipërfaqe nga 5 ha deri 50 ha : grurë (me së paku 180kg/ha fara të përdorura), misër (me së paku 15kg/ha farë të përdorur), elb (me së paku 160kg/ha farë të përdorur), oriz (me së paku 170kg/ha farë të përdorur), tritikale (me së paku 180kg/ha farë të përdorur), soja, luledielli, rrepë vajdhënëse, afion, pambuk, graor, esparzeta, bizele për kafshët dhe jonxhë me përdorim të domosdoshëm të materialit të certifikuar të farës në pajtim me sasinë e përdorur minimale të farës për hektar. - 6.000 den/ha për: grurë, elb, misër, thekër, tërshërë, tritikale, helda, sirak, mel, lentë, kikirikë, soja, luledielli, rrepë vajdhënëse, rrepë për kafshë, afion, rrepë sheqeri, pambuk, graor, esparzeta, bizele për kafshë, naut (slnutok) dhe jonxhë pa përdorim të detyrueshëm të materialit të certifikuar të farës. Prej 0,3 deri më 10 ha 100% Prej 10 deri më 50 ha 60% Prej 50 deri më 100 ha 30% Mbi 100 ha 10%	Për kërkesë të parashtruar për sipërfaqen me afion duhet: - Fotokopje e marrëveshjes për kultivim të afionit. Për kërkesë për sipërfaqe me përdorim të materialit të certifikuar të farës duhet: - Llogari fiskale me dokument shoqërues për identifikim për përkatësinë e llogarisë fiskale (fletëpagesë, fletëdërgesë, faturë e paguar në dorë) ose, - Faturë me fletëdërgesë për material të furnizuar të farës duke përfshirë edhe dëshminë për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë bankare). Në rast kur materiali i certifikuar i farës është i prodhimit personal, dorëzohet: - Vërtetim për farë përfundimtare të certifikuar dhe - Fletëdërgesë.
1.2	Pagesa plotësuese nga Nën masa 1.1 për sipërfaqe bujqësore të punueshme me madhësi nga 5 deri 50 hektarë	Nga 10 deri 50 ha gjithsej për sipërfaqe të mbjellura dhe korrura me material të certifikuar të farës për kulturat në vijim: elb, grurë, thekër, tërshërë dhe luledielli	5.760 den/ha për sipërfaqe të mbjellur me material të certifikuar të farës nga elb, grurë, thekër, tërshërë dhe luledielli Rendiment mesatr mbi: 4.000 kg/ha për grurë, 3.000 kg/ha për elb, 3.000 kg/ha për thekër, 3.000 kg/ha për tërshërë, 1.800 kg/ha për lulediell.	Ekonomia familjare bujqësore: - Llogari fiskale me dokument shoqërues për identifikim për përkatësinë e llogarisë fiskale (fletëpagesë, fletëdërgesë, faturë e paguar në dorë). - Vërtetim për prodhimtarinë e dhënë në kapacitete përpunuese për drithëra (Потврда за предадено производство во преработувачки капацитет за жито (elb, grurë, thekër, tërshërë dhe luledielli) të dhënë nga përpunues i regjistruar. Personi juridik: - Fatura me një dërgese për farat e blera, duke përfshirë dëshmi për pagesën e faturës nga (deklaratë bankare). - - Konfirmimi i prodhimit të arritur në kapacitetin e përpunimit të grurit (elb, grurë, thekër, tërshërë dhe luledielli) të lëshuara nga përpunuesit e regjistruar. Në rast kur materiali i certifikuar i farës është e prodhimit të vet, dorëzohet: - Vërtetim për farë përfundimtare të certifikuar dhe Fletëdërgesë
1.3	Pagesa plotësuese të drejtpërdrejt nga Nën masa 1.1 për sipërfaqe bujqësore të		- 1.000 den/ha ose 3.000den/ha për EFB me sipërfaqe nga 5 ha deri 50 ha për: elb, misër, thekër, tërshërë, tritikale, sirak, mel, lentë, soja, rrepë vajdhënëse, rrepë për kafshë, graor, esparzeta, bizele për kafshë, lucerkë dhe misër me zbatimin e sistemit për ujitje	Për kërkesë të parashtruar për sipërfaqen e mbjellur me material të certifikuar të farës të misrit me aplikimin e sistemit për ujitje është e nevojshme: Ekonomia familjare bujqësore: - Llogari fiskale me dokument shoqërues për identifikim për përkatësinë e llogarisë fiskale (fletëpagesë, fletëdërgesë, faturë e paguar në dorë). - Vërtetim/marrëveshje nga ndërmarrja e autorizuar për

	punueshme me ushqim për kafshë			<p>ekonomizim të ujërave se parcelat janë përfshirë me sistem të ujitjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim/dëshmi për pëlqimin nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për gropim të pusit për parcelën përkatëse . <p>Personi juridik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fatura me një dërgese për farat e blera, duke përfshirë dëshmi për pagesën e faturës nga (deklaratë bankare). - Vërtetim nga ndërmarrja kompetente për ekonomizim të ujërave se parcelat janë të përfshira me sistem të ujitjes. - Vërtetim/dëshmi për pëlqim nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për gropim të pusit për parcelën përkatëse. <p>Në rast kur materiali i farës është i prodhimit personal, dorëzohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim për farë të certifikuar përfundimtare dhe Fletëdërgesë
1.4	Pagesa plotësuese të drejtpërdrejt a nga nën masa 1.1 për sipërfaqe të punueshme bujqësore me luledielli dhe oriz		<p>- 3.000 den/ha për mbjellje të sipërfaqes me material të certifikuar të farës të orizit, lulediellit dhe afionit.</p> <p>- 6.000 den/ha për mbjellje të sipërfaqes me material të certifikuar të farës të lulediellit me zbatimin e sistemit për ujitje</p>	<p>Ekonomi familjare bujqësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llogari fiskale me dokument shoqërues për identifikim për përkatësinë e llogarisë fiskale (fletëdërgesë, faturë e paguar në dorë). - Vërtetim nga ndërmarrja kompetente për ekonomizim të ujërave se parcelat janë të përfshira me sistem të ujitjes. - Vërtetim/dëshmi për pëlqim nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për gropim të pusit për parcelën përkatëse. <p>Personi juridik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fatura me një dërgese për farat e blera, duke përfshirë dëshmi për pagesën e faturës nga (deklaratë bankare). - Vërtetim nga ndërmarrja kompetente për ekonomizim të ujërave se parcelat janë të përfshira me sistem të ujitjes. - Vërtetim/dëshmi për pëlqim nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor për gropim të pusit për parcelën përkatëse. <p>Në rast kur materiali i farës është i prodhimit personal, dorëzohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetim për farë të certifikuar përfundimtare dhe Fletëdërgesë
1.5	Pagesa të drejtpërdrejt a për sipërfaqe të punueshme bujqësore për prodhimtari kopshtarie në vende të hapura dhe sera	0,2 ha për secilën kulturë veç e veç, 0,1 ha për secilën kulturë veç e veç nëse të gjitha parcelat gjenden në lartësi mbidetare më të madhe se 700m në pajtim me SIPT	<p>- 30.000 den/ha ose 36.000den/ha për EFB me sipërfaqe nga 0,7 ha deri 5 ha për për secilën kultur veç e veç: domate, kastravecë, spec, patate, Lule prerë, fasule, bishtaja, bizele, tranguj, lakër, kel, qepë , hudhër, lakër jeshile, presh, brokoli, spinaq, lulelakër, patëllxhan blu, karrota, selino, panxhar, pastinak, asparagus,kungull i njomë rrepkë, të mbjellura kultivuara shëruese,bimë aromatike dhe erëza dhe për mirëmbajtjen e kultrave shëruese shumë vjeçare, bimë aromatike dhe erëza.</p> <p>- 6.000 den/ha ose 6.600den/ha për EFB me sipërfaqe nga 0,7 ha deri 5 ha për për secilën kultur veç e veç: për: shalqi, pjepër dhe trangull.</p>	Nuk dorëzohen dokumente.
1.6	Pagesat plotësuese të nënmasave 1.5 për prodhim nën kushte të kontrolluara të domatëve, specave, kastravecave dhe lule prerë	Sasitë minimale: -për oranzheri të cilat ngrohen: Domate 40.000 kg/ha, Specave 20.000 kg/ha, Krastaveca 80.000 kg/ ha -për sera të cilat ngrohen: Domate 8.000 kg/ha, Specave 4.000 kg/ha, Krastaveca 16.000 kg/ ha	-99.000 den/ha	<p>Ekonomia familjare ekonomike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dëshmi për prodhimtari të shitur në tregun e vendit prej 01.01.2018 deri më 15.05.2018 (faturë me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë të bankës),nëse fatura paguhet në dorë dorëzohet llogari fiskale dhe certifikatë bankare për pagesën e realizuar në dorë nga tregu ditor). <p>Subjekti juridik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dëshmi për prodhimtari të shitur në tregun e vendit prej më 01.01.2018 deri më 15.05.2018 (faturë me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë të bankës), nëse fatura është e paguar në dorë dorëzohet llogari fiskale dhe certifikatë e bankës për pagesë të realizuar në dorë nga tregu ditor) ose Deklaracion eksportues të doganave për eksportin e realizuar prej

				01.01.2018 deri më 15.05.2018 (faturë me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë e bankës)).
1.7	Pagesat plotësuese të nënmasave 1.5 për kultura të kopshtarisë të shitura në kapacitete përpunuese		- 3 den/kg	- Vërtetim për sasi të dhënë në industrinë përpunuese për perime të dhënë nga përpunuesi i regjistruar.
1.8	Pagesa plotësuese direkt për sipërfaqe punuese bujqësore për prodhim të fidanëve dekorues që rriten shpejtë		-6.000 den/ha	Nuk dorëzohen dokumente.
1.9	Pagesat direkte sipas sipërfaqes për mirëmbajtjen e fidanëve ekzistuese të pemëve	0.2 ha për \do lloj të pemëve posaçërisht, 0.1 ha për çdo lloj të pemëve posaçërisht, përderisa të gjitha parcelat gjinden në lartësi mbidetare më të madhe se 700m në përputhshmëri me SIPT	- 99.000 den/ha për dredhëza, në kushte të kontrolluara, - 33.000 den/ha ose 39.600den/ha për EFB me sipërfaqe nga 1 ha deri 5 ha për secilin lloj veç e veç për: dardhë, vishnje, kajsi, pjeshkë, mollë, kajsi, qersh, kumbull, boronicë, manaferrë, boronicë, dredhëz në ambient të hapur 25.000 den/ha ose 30.000den/ha për EFB me sipërfaqe nga 1 ha deri 5 ha për secilin lloj veç e veç për: aktinidija, ftua, mushmollë, ulli, shegë, mollë japone, fiq, aronija, rrush frengu, goxhi beri, bajame, lajthi, trëndafil i egër - 15.000 den/ha ose 18.000den/ha për EFB me sipërfaqe nga 1 ha deri 5 ha për secilin lloj veç e veç për: arra, dhe gështenja të buta Prej 0.2 deri 5ha 100% Prej 5 deri 30ha 60% Prej 30 deri 50ha 30% - Mbi 50ha 10%	Nuk dorëzohen dokumente.
1.10	Pagesa direkte plotësuese nga nënmasa 1.9 për pemëtari të dorëzuara në kapacitetet përpunuese		- 3 den/kg	- Vërtetim për sasi të dorëzuar në industri përpunuese për pemë.
1.11	Pagesa plotësuese direkt për rekonstruim të sipërfaqeve me fidane për ndrihimin e struktureve të varieteteve		-9.900 den/ha për rekonstruimin e varieteteve të: mollës, dardhës, kumbullës, pjeshkës, vishnjës, kajsisë dhe qershisë. -7.500 den/ha për rekonstruimin e varieteteve të: Ftoit, mushmullës, ulli, shegës, mollë japone, fiqit, bajamet dhe lajthisë. -4.500 den/ha për rekonstruimin e varieteteve të: arra dhe gështenja të buta	- Deklaratë nga aplikanti për rekonstruimin e fidaneve për ndrihimin e varieteteve në mënyrë të rimbjelljes. - Dëshmi për blerjen e fidaneve.
1.12	Pagesat direkte për sipërfaqe punuese	Numri i duhur minimal i fidaneve është 1.389 fidan/ha	-40.000 den/ha ose 48.000 den/ha për EFB me sipërfaqe prej 1 ha deri në 10 ha. Prej 0.2 deri 5 ha 100%	Nuk dorëzohen dokumente.

	bujqësore për mirëmbajtjen e hardhive ekzistuese	0.2 ha për 0.1 ha përderisa të gjitha parcelat gjinden në lartësi mbidetare më të madhe se 700m në përputhshmëri me SIPT	Prej 5 deri 30 ha 60% Prej 30 deri 50 ha 30% Mbi 50 ha 10%	
1.13	Pagesa plotësuese direkt për rekonstruim të sipërfaqeve me hardhisë për ndrrimin e strukturës së varieteteve		-12.000 den/ha për rekonstruim të hardhisë	- Deklaratë nga aplikanti për rekonstruimin e hardhisë për ndrrimin e varieteteve në mënyrë të rimbjelljes. - Dëshmi për blerjen e hardhive të rrushit. - Vërtetim nga katastra e hardhive për ndrrimin e varietetit të hardhisë me rimbjellje.
1.14	Pagesat direkte për prodhimin dhe shitjen e duhanit të papërpunuar nga rendimenti i vitit 2017		- 80 den/kg klasa e 1; - 70 den/kg klasa e 2; - 60 den/kg klasa e 1,2, 3 dhe e 4 nga llojet orientale shtesë të duhanit:prilep, jaka, xhebel dhe basmak; -	Nuk dorëzohen dokumente.
1.15	Pagesat direkte për prodhimin e materialit vendas farë të drithit të certifikuar nga gjenerata e parë dhe e dytë për kulturat drithërore, industriale kulturo kopshtare dhe patate	Sasia minimale e certifikuar e pranuar për kulturat drithërore është 2.5 ton për ha të sipërfaqes së paraqitur	- 60.000 den/ha për duhan, - 20.000 den/ha për gjeneratën e parë (C1) për kulturat e tjera - 5.000 den/ha për gjeneratën e dytë (C2) për kulturat e tjera	Certifikatë për sasi të prodhuara të materialit të farës. Dokument financiar për pagesë të realizuar të materialit të certifikuar nga gjenerata e parë dhe e dytë për kulturat drithërore, industriale kulturo kopshtare dhe patate në vitin 2018 (faturë me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar përmes faturës (certifikata bankare)).
1.16	Pagesat direkte për prodhim vendas të pipave të rrushit dhe fidanëve frutore për mbjellje		30 den/pip të vreshtave dhe fidan frutash nga kategorija CAC (STANDARD) materijal mbjellës. 35 den/pip të vreshtave dhe fidan frutash nga kategorija me e lartë	- Certifikatë për sasi të prodhuara të materialit të mbjellur. - Dokument financiar për pagesë të realizuar të spirales së certifikuar të vendit të prodhuar të vreshtave dhe materialit mbjellës të pemëve më së voni deri më 31 mars 2019 (faturë me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar përmes faturës (certifikata bankare)).
1.17.	Pagesa direkte për prodhim të materialeve për mbjellje për prodhime kopshtare		6 den/bimë,	- Certifikatë për sasi të prodhuara të materialit të farës. - Dokument financiar për shitje të realizuar të materialit prodhues të certifikuar të fidanëve për prodhime kopshtore në vitin 2018 (fatura me fletëdërgesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë bankare)).
1.18.	Pagesa direkte për		- 20 den/kg për materiale para elementare për farë, - 10 den/kg për materiale elementare për farë	- Certifikatë për sasi të prodhuara të materialit të farës.

	prodhim të materialeve para elementare dhe elementare për farë të kulturave drithërore			- Dokument financiar për shitje të realizuar të materialit prodhues para bazë dhe bazik të farës për kulturat drithore në vitin 2018 (fatura me fletëpagesë dhe dëshmi për pagesën e realizuar me faturë (certifikatë bankare)).
1.19.	Pagesa plotësuese direkte nga nën masa 1.5., 1.9., dhe 1.12. për përkrahje të ndryshimit të llojit të prodhimit të kulturave drithërore në kultura kopshtare, mbjellje pemë dhe hardhi për sipërfaqe bujqësore më të vogla se 5 hektar për EFB.		- 30% nga përkrahja e siguruar nga nën masa 1.5., 1.9. dhe 1.11.	- Nuk dorëzohen dokumente.

Tabela 2. Lartësia e përkrahjes për pagesa direkte për prodhimtari blektorale

Numri i nënmasës	Titulli i nënmasave	Numri minimal për kokë kafshe	Lartësia e përkrahjes	Dokumentet të cilat kërkuesi i parashtron si shtojcë e kërkesës
2.1	Pagesat direkte për koka të shënuara kafshësh		- 2.800 den /kokë ose 3.100 den/kokë për EFB nga 5 deri në 20 kokë. Prej 1 deri 100 koke 100% Prej 101 deri 150 koke 70% Prej 151 deri 300 koke 40% Mbi 300 koke 20%	Nuk dorëzohen dokumente.
2.2	Pagesa direkte shtesë nga nën-masa 2.1 për kope themelore për prodhim të mishit të lopës	30 kokë,	1500 den për kokë femër ne moshe prej 12 deri ne 24 muaj më 30.09.2018	Nuk dorëzohen dokumente.
2.3	Pagesat direkte për qumësht të prodhuar dhe shitur të lopës, dhenve dhe dhisë		3.5 den/litër për qumsht të lopës 4 den/litër për qumsht të dhenve dhe dhisë	Ekonomia bujqësore familjare: - Shënim blerës për sasi të dhënë të qumështit të lopës/dhisë/deles në kapacitet të regjistruar përpunues të regjistruara në Regjistrin e objekteve të lejuara për prodhimin e ushqimit me prejardhje nga kafshët. Subjekti juridik: Faturë me shënim blerës për qumësht të dhënë të lopës/dhisë/deles në kapacitet të regjistruar përpunues të regjistruar në Regjistrin e objekteve të lejuara për prodhimin e ushqimit me prejardhje nga kafshët.
2.4	Pagesat direkte për kok gjedhe të ruajtura dhe therura në kapacitetin therës të regjistruar		1.500 den per kokë	Vërtetim për frymë të prera të gjedhëve.
2.5	Pagesat direkte nga nën masa 2.5 për kok gjedhe të ruajtura dhe therura në kapacitetin therës të regjistruar për prodhim të mishit		4.000 den/ viç në moshë prej 8 deri 18 muaj nga racat:simental, oberintal, montafon, hereford, shkrole, busha dhe melz	Vërtetim për frymë të prera të gjedhëve.
2.6	Pagesa direkte për viç të marrë përmes V/O		1.200 den/viç i marrë në periudhën prej muajit maj 2017 deri në muajin prill 2018 2.500 den/viç femer i fituar ne bazë te farës së paperacaktuar (sex semen) në periudh nga maj 2017 deri ne prill te vitit 2018.	Ekonomia familjare bujqësore: - Vërtetim për V/O të realizuar të gjedhëve. Subjekti juridik: - Vërtetim për V/O të realizuar të gjedhëve. Në rast kur subjekti juridik vetë realizon V/O dorëzohet dokument financiar për farën e furnizuar.
2.7	Pagesat direkte për kokat e shënuara të dhenve nga të gjitha kategoritë	30 kokë 15 kokë nëse të gjitha fermat janë të regjistruara në vendbanime me lartësi mbidetare prej 700m ose me numër të banorëve më të vogël se 100	1.000 den/ kokë ose 1.100 den/ kokë për EFB nga 101 deri 500 kokë.	- Nuk dorëzohen dokumente.

2.8	Pagesat direkte plotësuese nga nën masa 2.8 për qengj të mbajtur femër		700 den/ kokë femër ne moshë prej 6 deri 18 muaj më 30.09.2018.	Nuk dorëzohen dokumente.
2.9	Pagesat direkte për kokë të dhive të shënuara	10 kokë 5 kokë nëse te gjitha fermat janë te regjistruara nëpër vendbanime ku lartësia mbidetare është mbi 700m ose ku numri i banorëve është më pak se 100	1.000 den/ kokë ose 1.100 den/ kokë për EFB nga 101 deri 500 kokë.	Nuk dorëzohen dokumente.
2.10	Pagesat direkte shtesë nga nën masa 2.9 për edh të mbajtur femër		700 den/kokë të edhit femër të moshës prej 6 deri në 18 muaj më datë 30.09.2018	Nuk dorëzohen dokumente.
2.11	Pagesat direkte për kokë femërore pjellore – dosa	2 kokë	1000 den/kokë ose 1.100 den/kokë për EFB nga 6 deri 50 kokë	- Vërtetim për gjendjen e numrit të dosave të dhënë nga stacioni i regjistruar i veterinarisë.
2.12	Pagesat direkte plotësuese nga nën masa 2.11 për kokë të regjistruar- dosa		-20% për koë të regjistruar nga pagesa e paraparë ne nënmasen 2.11	Nuk dorëzohen dokumente.
2.13	Pagesat direkte për kafshët e ruajtura dhe të prera në kapacitete të regjistruara të thertoreve	5 kokë 2 kokë nëse të gjitha kopetë janë të regjistruara në vendbanime me lartësi mbidetare më të madhe se 700m ose me numër të banorëve më të vogël se 100	1000 den/kokë me masë nga 90 deri 120 kg 2000 den/kokë me masë minimale prej 121 kg Prej 5 deri në 5.000 kokë 100% Prej 5001 deri në 15.000 kokë 80% Mbi 15.000 kokë 40%	- Vërtetim për derrkucë të prerë.
